

# Ku mund të sigurohen informata të mëtejshme?

■ Telefon:

**020 7035 2898**

■ Letër për:

The Ombudsman  
Ashley House  
2 Monck Street  
London  
SW1P 2BQ

■ Vizitoni faqen tonë elektronike në:

[www.ppo.gov.uk](http://www.ppo.gov.uk)

Kjo broshurë mund të sigurohet edhe në gjuhë të tjera.


Lutemi të kërkonti kopje nga qendra e largimit e imigracionit,  
Ose telefononi 020 7035 2898.



# BESONI TEK ANKESA

**Si të bëni një ankesë  
pranë Ombudsmanit**

## Kur mund të ankoheni pranë nesh?



Së pari, duhet të shfrytëzoni sistemin e ankesave të imigracionit për të gjetur zgjidhje për problemin tuaj

- Bisedoni me personelin e qendrës së largimit për të parë nëse çështja mund të zgjidhet në mënyrë jo-zyrtare.
- Në rast se ata nuk mund t'ju ndihmojnë, bëni një ankesë zyrtare duke plotësuar formularin.

Në rast se nuk kënaqeni me përgjigjen që merrni, mund të ankoheni pranë nesh, por këtë duhet ta bëni brenda **një muaji** nga marrja e përgjigjes.

## Si bëhet ankesa pranë nesh?

Plotësoni formularin që është bashkëngjitur me këtë letër ose na shkruani, nëse dëshironi, duke paraqitur hollësitë e ankesës. Fillimisht na nevojiten vetëm pak hollësi, por do të ishte e dobishme po të na dërgonit formularin e ankesës. Ju kontaktojmë vetë në rast se kemi nevojë për informata të mëtejshme.

Në rast se keni vështirësi për të lexuar apo shkruar, kërkoni ndihmën e ndonjë shoku a të afërmi apo një anëtar të Bordit të Pavarur të Mbikqyrjes.

## Besoni tek ankesa

## Kush mund të ankohet?

Të gjithë të ndaluarit e imigracionit kanë të drejtë të ankohen pranë nesh.



## Për çfarë mund të ankoheni?

Mund të ankoheni pothuajse mbi çdo gjë që ka të bëjë me mënyrën si ju kanë trajtuar gjatë kohës së paraburgimit. Sidoqoftë, Ombudsmani nuk merret me ankesat që kanë të bëjnë me dosjen tuaj të imigracionit, përfshirë edhe vendimin e mundshëm mbi largimin tuaj nga Mbretëria e Bashkuar.

## Çfarë ndodh pasi të keni bërë ankesën?

Ne e lexojmë ankesën tuaj dhe ju përgjigjemi me shkrim brenda 10 ditëve, duke ju treguar nëse e pranojmë ankesën tuaj. Në rast se nuk e pranojmë, ju shpjegojmë arsyen përse.

## Si vendosim nëse jemi dakort me ankesën tuaj?

Ne e trajtojmë ankesën tuaj duke rishqyrtuar provat edhe një herë dhe duke arritur në një përfundim mbi rrugëzgjdhjen më të mirë. Pavarësisht nga mënyra si përfundon ankesa juaj, ne gjithnjë ju tregojmë arsyet që na kanë çuar në marrjen e vendimit.



## Çfarë ndodh kur ne hetojmë mbi ankesën tuaj?

Informacionin mbi ankesën tuaj ne e sigurojmë nga ju, Shërbimi i Imigracionit dhe nga kushdo që mendojmë se mund të na ndihmojë. Më pas përpiqemi që ankesën tuaj ta zgjidhim në njërin nga mënyrat e mëposhtme.

- Zgjidhje vendore – Kjo nënkupton gjetjen e një zgjidhjeje për të cilën bini dakort ju dhe qendra e largimit. Shpeshherë kjo është mënyra më e shpejtë për zgjidhjen e ankesës.
- Një raport i shkurtër apo një letër – Këtë mënyrë e shfrytëzojmë në rastin kur palët nuk bien dakort. Edhe kjo mund të jetë zgjidhje e shpejtë.
- Raport i plotë – Edhe këtë mënyrë e shfrytëzojmë në rastin kur palët nuk bien dakort. Ai është shumë më i hollësishëm se raporti i shkurtër dhe kërkon kohë më të gjatë për t'u shkruar.

Hetimin ne e përfundojmë brenda 12 javëve, por në shumicën e rasteve shumë më shpejt se kjo periudhë. Në rast se biem dakort me ankesën tuaj, raporti do të përfshijë edhe rekomandimet që ne i bëjmë Shërbimit të Imigracionit mbi masat që duhet të marrin për ta korrigjuar situatën.

The Ombudsman  
Ashley House, 2 Monck Street, London SW1P 2BQ  
Telefoni: 020 7035 2898  
E-mail: [immigrationcomplaints@ppo.gsi.gov.uk](mailto:immigrationcomplaints@ppo.gsi.gov.uk)  
[www.ppo.gov.uk](http://www.ppo.gov.uk)

# Formular kërkesë

Lutemi të plotësoni formularin e mëposhtëm dhe të na e dërgoni.

## Të dhënat personale

Mbiemri:  Titulli honorifik (Z, Znj, Zonjushë):

Emri:

Numri i referencës i dosjes së Imigracionit:

Datëlindja:  /  /

Lutemi shënoni emrin e qendrës së largimit të imigracionit ku mbaheni i ndaluar.

Lutemi jepni hollësi të nevojave të posaçme që duhet të mbajmë parasysh kur trajtojmë ankesën tuaj apo në korrespondencën me ju.

## Ankesa juaj

Në cilën qendër të largimit të imigracionit ndodheshit kur lindi çështja për të cilën po ankoheni? Në rast se ndodhi gjatë shoqërimit, tregoni pikën e nisjes dhe të mbërritjes.

A është shqyrtuar ankesa juaj nga Shërbimi i Imigracionit? Po  Jo

Në rast se 'Po', lutemi na dërgoni një kopje të përgjigjes së tyre. Në rast se nuk keni marrë përgjigje, ka pak gjasa që ne të mund ta hetojmë ankesën tuaj.

Në rast se ankesa ka të bëjë me humbjen apo dëmtimin e pasurisë, lutemi na dërgoni një përshkrim të plotë të sendeve, informata mbi vendin dhe kohën e blerjes, dhe faturat që mund të dispononi.

Përse po ankoheni? (mund të vazhdoni në një fletë letre tjetër po të jetë e nevojshme)

Kur ndodhi?  /  /

Çfarë mendoni se duhet bërë për ta zgjidhur çështjen?